



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA DIBËR
DPZHT

5001
Nr. ____ Prot

Peshkopi, më 28/10.2022

Lënda: Lërkësë për paisje me Akt Përputhshmërie në kuadër të rishikimit të Planit të përgjithshëm Vendor të Bashkisë Dibër.

Adresa: "Muhamet Gjollesha", Nr.57, Tiranë

ZNJ. ADELINA GRECA

AGJENCISË KOMBETARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Bashkia Dibër ka të miratuar dhe ka ne fuqi aktualisht Planin e Përgjithshëm Vendor me vendimin Nr.2 datë 14.04.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit.

Pas miratimit të këtij Plani Bashkia Dibër ka monitoruar zbatimin e tij në vazhdimësi dhe ka ndërmarrë nismën për rishikimin e tij për dsa arsye të cilat janë trajtuar në dokumentin e nismës së rishikimit të PPV-së.

Në zbatim të nenit 23, pika 14 të ligjit 139/2015 datë 1.7.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore," neni 13, pika 1, shkronja "b", neneve 23,24,25 dhe 26 të ligjit Nr. 107 datë. 31.07.2014 për planifikimin dhe zhvillimin të territorit I ndryshuar, neneve 10,11 dhe 12 të VKM nr. 686, datë 22.11.2017 për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit, e ndryshuar si dhe udhezimit nr.1, datë 22.02.2019 të Drejtorit të përgjithshëm të AKPT për hartimin bashkërendimin miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumentave të përgjithshme vendore me procedure të thjeshtuar. Bashkia Dibër ka kryer procesin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor për territorin e saj administrativ.

Në vijim bazuar në nenin 9 pika 2, neni 13, pika 1. shkronja "d". nenet 23 dhe 25 të Ligjit nr. 107 datë. 31.07.2014 për planifikim e zhvillimin e territorit I ndryshuar nenin 2, pika 2, neni 5,6 dhe 8 neni 60 pika 3 shkronja "a", neni 62 pika 2, shkronjat "a", "b", "c" të VKM nr.686 datë. 22.11.2017 për miratimin e rregullores së Planifikimit të Territorit e ndryshuar, kërkojmë nga AKPT lëshiminn e Aktit të Përputhshmërisë për dokumentin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Dibër.

Duke ju falenderuar paraprakisht!

KRYETARI I BASHKISË DIBËR

